



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

156/21
/Br.

Datë/Datum. 24.03.21 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PRISHTINË • PRIŠTINA PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.156/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenović – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Toifor”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorët ekonomik: K.N.P.SH “Papenburg & Adriani Company”SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe rindërtimi i kanalizimit fekale dhe atmosferik në Komunën e Prishtinës”, me nr. të prok: 616-20-8123-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, më datën: 23.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Toifor”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe rindërtimi i kanalizimit fekale dhe atmosferik në Komunën e Prishtinës”, me nr. të prok: 616-20-8123-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”,

II. VERTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe rindërtimi i kanalizimit fekale dhe atmosferik në Komunën e Prishtinës”, me nr. të prok: 616-20-8123-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Toifor"SH.P.K-Prishtinë, i aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: "Toifor"SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.02.2021 me nr. 156/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe rindërtimi i kanalizimit fekale dhe atmosferik në Komunën e Prishtinës", me nr. të prok: 616-20-8123-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prishtinë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 6 , 7 , 59 , si dhe nenin 60 të LPP-së, te ankesa me nr. 156/21.

Organji Shqyrtues i Prokurimit, konfirm nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e datë: 04.03.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Toifor"SH.P.K-Prishtinë,

Përgjigje në pretendimin nr.1, OE ankues pretendon që AK-ja nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, për shkak se ka bërë favorizime të qarta dhe duke u thirre në atë se për disa pozicione ne kemi ofruar çmime të larta por në fakte është e kundërtë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmimin 9.73 për njësi, madje edhe për OE tjerë të cilët kanë ofruar çmime më të larta AK-ja nuk i trajton si OE me çmime të larta por i trajton në përputhje me poentimin, ndërsa tek ne në asnjë rrethanë asnjë pozicion nuk mund të trajtohet si i tillë sepse edhe me çmim për poentim edhe me çmim për njësi jemi më të lirë. Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë në shumë pozicione ka ofruar çmime më të larta sepse edhe me poentim edhe në total del më i lartë andaj në cilindo aspekt ne jemi me çmim më të arsyeshëm dhe kjo është në kundërshtim me nenin 6 të LPP-së. Eksperti shqyrtues thekson se qëllimi i Nenit 7 të LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve. Ndërsa në nenin 6 të LPP-së thuhet: "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që

të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit". Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është rekomanduar për kontratë OE K.N.P.SH "PAPENBUR & ADRIANI" COMPANY SH.P.K me çmimin total të poentuar 9.73 euro"OE ankues "TOIFOR" Sh.p.k. Prishtinë ka ofruar çmimin total të poentuar 8.57 euro, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar sqarime OE ankues për disa pozicione që OE ankues ka ofertuar me çmimin të lartë, dhe OE ankues i ka ofruar sqarime për të cilat AK-ja nuk është bindur. Eksperti shqyrtues saron se në paramasën e ofruar nga AK-ja janë vendosur poenët nëpër pozicione varësisht nga pesha dhe rëndësia për secilin pozicion. Andaj eksperti shqyrtues vlerëson se tek kriteri tenderi me çmimin më të ulët të poentuar ka qenë kërkesë e AK-së, andaj në bazë të kësaj kërkesë është dashur të rekomandohet për kontratë OE i cili ofron çmimin më të ulët të poentuar, pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm. Për situata të tillë PSH i OSHP-së në vendimin me nr.568/19 ka vendosur si në vijim:

Duke pas bazë kriterin çmimi më i ulet i poentuar Autoritetit Kontraktues i lejohet që varësisht prej rëndësisë që kanë artikujt të mund ti poentoj në mënyrë që të vjen deri te çmimi më i arsyeshëm, pasi që vierësimi i ofertavec në këtë rast behet ne bazë të poenavc që i është dhenë secilit pozicion dhe për kontratë rekomandohet OE i cili ofron çmim më të ulet të poentuar, ndërsa kontrata nënshkruhet dhe realizohet sipas çmimeve të ofruara sepse tek ky kriter nuk lejohet qe të përcaktohen piket duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm dhe se funksioni i vetëm i peshimit te çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët.

Mendimi i ekspertit shqyrtues, Duke u bazuar në sqarimet e lartpermendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE "TOIFOR" Sh.p.k. Prishtinë, të aprovohet si e bazuar të anulohet njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04.03.2021 me raportin e ekspertizës,

Autoriteti Kontraktues, me datë: 08.08.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar, Konfirmojmë pranimin e ekspertizës dhe deklarojmë se nuk pajtohem me mendimin dhe sqarimet e ekspertit. Arsyet e mospajtimit janë si vijon:1.Perkunder mendimit tuaj te vazhdueshëm se me rastin e kriterit te çmimit me te ulet te peshuar nuk duhet te aplikohen rregullat për tenderët jo normalisht

te ulet pasi qe peshimi pamundëson manipulimin me çmime, ju sqaroj se nga te gjithë shembujt nga praktika ne këto raste mundësi e manipulimit është larte ne te gjitha rastet; 2.Nuk qëndron konstatimi se Autoriteti Kontraktues ka krahasuar çmimet e ofertave te tenderueseve, por vetëm ka konstatuar se çmimet për disa pozicione janë shume mbi çmimet e tregut dhe si te tilla janë te pa pranueshme për tu kontraktuar pasi qe bien ne kundërshtim me dispozitat ligjore sipas te cilave gjithmonë duhet te kemi kujdes qe te mos kontraktojmë çmime te tilla; 3.Nga analiza e disa projekteve te realizuara ne te kaluarën rrjedh se për Autoritetin kontraktues do te ishte me e leverdishme te kontraktohen ofertuesit e ranguar me çmime te peshuara me te larta(qe kane çmime reale) se sa çmimi me i ulet i peshuar(me çmime mbi çmimet e tregut ne disa artikuj).Lidhur me këtë kemi pasë edhe një analize te Zyrës Kombëtare te Auditimit qe e ka vërtetuar te njëjtën gjë. Bazuar ne këtë ne si Autoritet Kontraktues nuk mund te pranojmë kontrakte me çmime me te larta nga çmimi i tregut, por nëse Paneli Shqyrtues pranon mendimin e ekspertit atëherë ne nuk do te marrim përgjegjësi për dëmtimet qe do te mund ti shkaktohen Buxhetit me çmime te tilla. Me respekt,

Operatori Ekonomik: Toifor”SH.P.K-Prishtinë, me datë 04.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për konratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Ne lidhje me pretendimet e OE ankues që AK-ja nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, për shkak se ka bërë favorizime të qarta dhe duke u thirre në atë se për disa pozicione ne kemi ofruar çmime të larta por në fakte është e kundërta OE i rekomanduar për konratë ka ofruar çmimin 9.73 për njësi, madje edhe për OE tjerë të cilët kanë ofruar çmime më të larta AK-ja nuk i trajton si OE me çmime të larta por i trajton në përputhje me poentimin, ndërsa tek ne në asnje rrëthanë asnje pozicion nuk mund të trajtohet si i tillë sepse edhe me çmim për poentim edhe me çmim për njësi jemi më të lirë. Po ashtu OE i rekomanduar për konratë në shumë pozicione ka ofruar çmime më të larta sepse edhe me poentim edhe në total del më i lartë andaj në cilindo aspekt ne jemi me çmim më të arsyeshëm dhe kjo është në kundërshtim me nenin 6 të LPP-së, Paneli shqyrtues thekson se qëllimi i Nenit 7 të LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jo

diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe ne rastin konkret AK ka respektuar ketë nen duke kërkuar sqarime shtese nga te gjithë OE te cilat kane ofruar çmime mbi çmimin e tregut.

Paneli Shqyrtues sqaron se në paramasën e ofruar nga AK-ja janë vendosur poenët nëpër pozicione varësisht nga pesha dhe rëndësia për secilin pozicion. Andaj Paneli shqyrtues konstaton se tek kriteri tenderi me çmimin më të ulët të poentuar ka qenë kërkesë e AK-së, andaj në bazë të kësaj kërkesë është dashur të rekomandohet për kontratë OE i cili ofron çmimin më të ulët të poentuar, megjithatë ne rastin konkret nuk behet fjale për çmime abnormalë **por për çmime te ofruara mbi çmimin e tregut**. Neni 4.2 i RUOPP përcakton: *4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim: a) të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive; Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 9 b) për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuар avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet, dhe c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.* Gjithashtu neni 6 i LPP-se përcakton "*Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*".

Për qellim te vlerësimit korrekt te çmimeve, nisur nga fakti qe AK kohëve te fundit nuk kishte pranuar çmime për shume pozicione ne ofertat e pranuara për aktivitete te tjera te prokurimit, për te analizuar këto çmime AK është bazuar ne çmimet referente nga manuali i KRPP-se. Ne baze te manualit është konstatuar se te njëjtat janë me se vijon: për kategorinë e III çmimi me transport deri ne 10 km është 4.40, për kategorie e IV 4.26, për kategorinë V gjermimi me çekan është 16.36, ndërsa për kategorinë e VI 22.27 euro. Për dy kategoritë e fundit (IV dhe V) është shtuar edhe transporti 2.44 e qe ne total çmimi për kategorinë V është 18.80 ndërsa për kategorinë VI është 24.71. Pasi qe te gjitha këto pozicione janë te përfshira ne një pozicion rrjedh qe çmimi mesatar është 13.09. Duke pasur parasysh se transporti mund te jete ne largësi me te madhe AK ka vlerësuar se çmimi maksimal i pranueshëm për gjermim me ekskavator nuk mund te jetë me i larte se 15 euro m³ ndërsa për gjermim me dore nuk mund te jetë me i larte se 14 euro. OE ankues për pozicionin 2.1 ka ofertuar çmimet 50 dhe ndërsa për pozicionin 2.2 ka ofruar çmimin 30 euro m³ qe është shume me i larte se sa çmimi i tregut.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron; se AK gjatë administrimit të procedurave të prokurimit ka respektuar nenin 4.2 te RUOPP duke siguruat që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se sa çmimi i tregut.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 /AK/ - "KK-Prishtinë",
- 1x1 / OE/ Toifor"SH.P.K-Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së